



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 24-36 MUAJSH **MUAJI SHKURT**



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

<http://femijetetiranes.al/>

 Fëmijët e Tiranës

 femijet_e_tiranes

Programi i Edukimit për Fëmijët 24-36 Muajsh/ Muaji Shkurt

Kuriozitete për muajin SHKURT.



Çfarë duhet të dimë për muajin Shkurt?

- **Shkurti** është muaji i fundit i stinës së dimrit dhe muaji i dytë i vitit.
- Muaji Shkurt quhet i tillë, sepse është muaji me më pak ditë i vitit.
- Muaji Shkurt ka 28 ditë dhe një herë në katër vjet ka 29 ditë. Viti ku muaji Shkurt ka 29 ditë është i njohur edhe si “Viti i Brishtë”.
- Në muajin Shkurt fillojnë të çelin lulet e para të pranverës si: lule mimoza, manushaqja, lulja e qershisë etj.


Muaji Shkurt – “Përrallat dhe personazhet e tyre”
Grupi miks: 24-36 muajsh







- Java I:** Bota e përrallave.
- Java II:** Personazhet më të dashur të përrallave.
- Java III:** Bota e kafshëve përmes përrallave.
- Java IV:** Teatri i kukullave.






Tema Mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre		
Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Bota e përrallave.	Njohja e fëmijëve me botën e përrallave dhe personazhet kryesorë të tyre.	Java I
Personazhet më të dashur të përrallave.	Njohja me përrallat klasike, shqiptare dhe ato të reja. Emocionet që përjetojmë kur lexojmë përralla dhe njohja me veshjet e personazheve.	Java II
Bota e kafshëve përmes përrallave.	Njohja e kafshëve përmes përrallave: kafshët shtëpiake, kafshët e pyllit, bota ujore dhe e insekteve.	Java III
Teatri i kukullave.	Njohja me teatrin e kukullave, përgatitja e një shfaqjeje teatrale në çerdhe.	Java IV

Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Bota e përrallave			
Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E hënë	Njohja me botën e përrallave 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u tregon fëmijëve libra të ndryshëm me përralla nga ato që kanë në grup dhe i'u shpjegon elementët real dhe jo real që përrallat përmbajnë (si sirenat e detit, zanat e malit, kafshë që flasin, njerëz që fluturojnë). Ajo i'u tregon se përrallat na mësojnë, na edukojnë dhe na argëtojnë.</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i një përralle nëpërmjet figurave të prera nga revista/libra me përralla. Formoni përrallën e zgjedhur, bashkë me fëmijët ndërkohë ritregoni përrallën me fjalët tuaja (zgjedhja e përrallës lihet e lirë).</p> <p>Kënga: “Kokëkashta”.</p> <p>Loja energjike: Loja e tunelit (improvizuar me rrathë)</p>	Mjete didaktike: revista me përralla, libra me përralla -Manuali i vjershave -Manuali plotësues

<p>E Martë</p>	<p>Personazhet e përrallave</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u flet fëmijëve mbi personazhet më të njohur të përrallave si: Kësulkuqja, Tre Derrkucët, Çufo dhe Bubi Kaçurrel, etj.</p> <p>Edukatorja pyet: Cili është personazhi juaj i preferuar?</p> <p>Përralla: “Tre Derrkucët”</p> <p>Aktivitet: Edukatorja bashkë me fëmijët ndërtojnë tre shtëpitë sipas përrallës (me materiale të përgatitura më parë).</p> <p>Kënga: “ Kokëkashta”</p> <p>Lojë energjike: Hedhja e topit në kosh.</p>	<p>-Mjete didaktike: kuba me ngjyrë kafe (materiale të tjera,) top, tabelë, kosh</p> <p>- Manual plotësues</p> <p>- Manuali i vjershave</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Librat</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve rëndësinë e librave dhe si të kujdesemi për to. Ata na japin dije, librat na ndihmojnë të mësojmë fjalë të reja, të flasim bukur etj.</p> <p>Edukatorja pyet: Ku i gjejmë librat? (në librari, në bibliotekë, në panairin e librit?)</p> <p>Aktiviteti: Riparojmë një libër të dëmtuar.</p> <p>Vjersha: “Librat rrinë radhë radhë”.</p> <p>Loja: Dyqani i librave. Edukatoria improvizon shitjen e librave dhe fëmijët orientohen të mbajnë rradhën dhe të zgjedhin librin që dëshirojnë.</p>	<p>-Mjetet didaktike : libra, ngjitës, gërshërë.</p> <p>Manuali i vjershave</p>

<p>E Enjte</p>	<p>Gjumi dhe përrallat</p> 	<p>Bisedë: Edukatore -fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve rëndësinë e gjumit dhe të leximit të përrallave para gjumit, që fëmijët të bëjnë gjumë të qetë.</p> <p>Edukatorja pyet : - A i'u tregojnë prindërit apo gjyshërit përralla përpara gjumit? -Cila është përralla e tyre e preferuar?</p> <p>Vjersha: “ Nina -nana Kukulla”/ “Sara e vogël”.</p> <p>Aktiviteti: Vendosja e kukullës në gjumë, ndërkohë edukatorja lexon një përrallë.</p> <p>Loja energjike: Loja me birrila/me karrige.</p>	<p>Mjetet e punës: kukulla, krevati i kukullës.</p> <p>Manuali i vjershave.</p> <p>Manuali plotësues</p>
<p>E Premte</p>	<p>Emocionet në përralla</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve katër emocionet bazë: i/e gëzuar, i/e mërzitur, i/e habitur, i/e zemëruar. Zbulojmë së bashku këto emocione në përrallën “Rosaku i Shëmtuar ”</p> <p>Përralla: “ Rosaku i shëmtuar” .</p> <p>Aktiviteti: Demonstrimi i emocioneve me pjata plastike. Me anë të pjatave plastike në të cilat janë vizatuar emocionet, fëmijët shoqërojnë emocionet që iu shkakton përralla 😊 për gëzimin, 😞 për mërzitjen, 😲 për habitjen dhe e për pjesën ku përralla iu shkakton zemërim 😡 .</p> <p>Këngë lëvizore “ Nëse je vërtet i lumtur ”</p>	<p>-Mjete didaktike: pjata plastike, lapustil.</p> <p>Manuali i vjershave</p>




Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Personazhet më të dashur të përrallave.			
Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E hënë	Përrallat klasike 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve personazhet kryesorë të përrallave klasike dhe mesazhet që ato përcjellin si: Borëbardha, Kësulkuqja, Rosaku i Shëmtuar, Pinoku etj.</p> <p>Aktivitet: Leximi i përrallës “Pinoku” në grup. Pas leximit të përrallës edukatorja bashkë me fëmijët diskutojnë për gabimet e pinokut (pinoku gënjeu babanë, u largua pa leje, u shoqërua me të panjohur). Edukatorja ndihmon fëmijët të kuptojnë pse pinokut iu rrit hunda dhe përse nuk duhet të gënjejnë.</p> <p>Loja: Ecim sipas formave gjeometrike. Edukatorja formon një rrjesht me figura të ndryshme gjeometrike. Çdo fëmijë i kërkohet të ndjeki një trajektore të caktuar. P.sh. Ana - ▲ , Eno-■, Dea- ●.</p> <p>Vjersha: “Dëshirat e pinokut/kënga e pinokut”.</p>	<p>-Mjete didaktike: kartona me ngjyra, ngjitës,gërshërë.</p> <p>-Manali i vjershave</p> <p>-Manuali plotësues.</p> 
E Martë	Përrallat e reja 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u flet fëmijëve mbi përrallat e reja si:“Maçoku me Çizme”, “ Mbretëreshat e Dëborës”, “Hirushja”, “Bambi” etj.</p> <p>Përralla: “Derrkucja Pepa”.</p> <p>Aktivitet: Ngjyrosja, prerja dhe ngjitja e personazheve në këndin e personazheve.</p> <p>Vjersha: “Dëshirat e pinokut”/ “Kënga e pinokut”.</p>	<p>-Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fleta, top, tabelë, kosh etj</p> <p>-Manali i vjershave</p> <p>-Manuali plotësues.</p>

		Loja: Lojë me top, kapja dhe pasimi i topit	
E Mërkurë	<p>Përrallat shqiptare; përrallat me kafshë.</p> 	<p>Bisedë. Edukatore-fëmijë: Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve përrallat me kafshë, mesazhin që përcjellin personazhet kryesorë të tyre si “Dhëlpër dhe lejleku”, “Arushi që Kërkonte Babanë” “Çufo dhe Bubi Kaçurrel” “Kokëkashta”.</p> <p>Përralla: “Dhëlpër dhe lejleku” Pas leximit të përrallës, edukatorja j'u përcjell fëmijëve mesazhin: “Ashtu siç ju sillemi të tjerëve, ashtu do të na sillen. Nëse sillemi mirë dhe të tjerët do të sillen mirë me ne.”</p> <p>Aktiviteti: Edukatorja ju jep vizatimet dhe fëmijët ngjyrosin personazhet kryesore (dhëlpër, ujku, lejleku, kecat.)</p> <p>Vjersha: Shkoi dhëlpër çalë-çalë</p> <p>Loja lëvizore : Dhëlpër</p>	<p>Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, fleta.</p> <p>Manali i vjershave</p> <p>Manuali plotësues.</p> 
E Enjte	<p>Përrallat shqiptare me personazhe.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i' u shpjegon fëmijëve përrallat shqiptare, kryesisht ato me personazhe si “Pipiruku”, “Fatbardh Pikaloshi” dhe ju flet për mesazhin që përcjellin personazhet kryesorë të tyre.</p> <p>Aktivitet: “Shikimi në pc/projektor i përrallës “ Pipiruku”.</p> <p>Kënga “Pipiruku”</p> <p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin/punojnë me plastelinë personazhin e milingonës.</p>	<p>Mjete didaktike: lapsa me ngjyra, plastelinë</p> 
E Premte	<p>Parada me veshjet e personazheve të përrallave.</p>	<p>Aktivitet: Krijimi i veshjeve, maskave të personazheve të përrallave me plastelinë ose karton. Përmes lojës “bëj sikur” fëmijët imitojnë</p>	<p>Mjete didaktike: karton plastelinë, ngjyra,ngjitës, llastik.</p>



personazhin e maskës që kanë vendosur.

Përsëritje e aktivitetit javor



Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.			
Tema javore: Bota e kafshëve përmes përrallave.			
Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E hënë	Kafshët shtëpiake. 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve kafshët shtëpiake si: qeni, macja, kali, lopa, derrkuci, delja, dhia etj. Ajo i'u tregon ku jetojnë ato, me çfarë ushqehen dhe fëmijët imitojnë tingujt e tyre, etj.</p> <p>Përralla: “Muzikantët e Bremenit”.</p> <p>Vjershë: “Ga -ga-ga ia bëjnë patat ”, “Pulat dhe bubi i vogël”</p> <p>Loja: Hedhja e kubit (ku në çdo faqe të kubit ka figura kafshësh, tingujt e të cilave fëmijët i imitojnë)</p>	Mjete didaktike: Letra, ngjitës, Manuali plotësues Manuali i vjershave 
E Martë	Kafshët e pyllit/të xhunglës 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i' u flet fëmijëve për kafshët që jetojnë në pyll si lepuri, ariu, ujku, dhelpra, kaprolli, etj. Ajo demonstron tingujt që ato lëshojnë dhe i'u tregon karakteristikat e tyre.</p> <p>Edukatorja i'u tregon fëmijëve kafshët që jetojnë në xhungël (luani, zebra, majmuni) etj.</p> <p>Edukatorja pyet: Cila kafshë ju pëlqen më shumë dhe përse?</p> <p>Përralla: “Mbreti i xhunglës”.</p> <p>Aktiviteti: Tabela e lotos me kafshët e pyllit.</p> <p>Kënga: “Në tropik”.</p>	Mjetet didaktike: letra, lapsa me ngjyra, tabak kartoni, figura të ndryshme kafshësh, Manuali plotësues Manuali i vjershave
E Mërkurë	Bota ujore.	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u shpjegon fëmijëve botën ujore si peshqit, delfinët, balenat. Ajo ju tregon fëmijëve se ato jetojnë në det, lumë, liqen, oqean. Fëmijët me ndihmën e edukatores, rendisin përrallat</p>	Mjete didaktike: letra, çarçaf me ngjyrë blu ngjyra etj. Manuali plotësues

		<p>me personazhe të botës ujore.</p> <p>Përralla: “Sirena e vogël”.</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i një akuariumi me peshq, guaska etj, me materiale të riciklueshme.</p> <p>Vjersha: “Dy peshqit e kuq”, “Ylli i detit ”.</p> <p>Loja: Të shkojmë për peshkim (improvizim i një ditë peshkimi).</p>	<p>Manuali i vjershave</p>
<p>E Enjte</p>	<p>Bota e insekteve.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i’u shpjegon fëmijëve insektet si mizat, milingonat, buburrecat, merimangat, fluturat. Edukatorja i’u flet për llojet e tyre dhe ku jetojnë ato.</p> <p>Aktiviteti: Krijimi i insekteve me gishtat, duart dhe këmbët e fëmijëve.</p> <p>Fabula: “Milingona dhe gjinkalla”.</p> <p>Vjersha: “Miza”</p> <p>Loja: Lojra energjike me shami/ me karrige/ me top.</p>	<p>Manuali i vjershave. Manual plotësues Mjete didaktike</p> 
<p>E Premte</p>	<p>Loja më e bukur për mua</p> 	<p>Ngjyrosje: Fëmijët ngjyrosin modele-personazhe të ndryshme të përrallave, të krijuara më parë nga edukatorët. (Edukatorët mund të përdorin modele si ky materiali).</p> <p>Aktivitet: Edukatorët me fëmijët në grupe kërcëjnë/improvizojnë përmes këngëve lëvizore:</p> <p>Këngë lëvizore: “Tingujt e kafshëve.”</p> <p>“ Kënga e lejlekut”</p>	<p>Mjete didaktike: Letra të bardha, lapsa me ngjyra</p> <p>Manuali i vjershave</p>

Tema mujore: Përrallat dhe personazhet e tyre.

Tema javore: Teatri i kukullave.

Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Teatri i kukullave</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja i'u flet fëmijëve për teatrin e kukullave, si është i ndërtuar ai. Në teatër ka shumë aktorë, ata janë të veshur me kostume sipas shfaqjes që japin.</p> <p>Edukatorja pyet: Ku ndodhet teatri i kukullave? A kanë qënë ndonjëherë në teatër?</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i skenës së teatrit të kukullave me çarçaf ose karton. Improvizimi nga edukatoret i një shfaqjeje teatrale.</p> <p>Përralla: “Tre Derrkucët” ose “Kësulkuqja” (teatri i kukullave, shikimi i përrallës në pc/projektor) ose ua rrëfen atë.</p> <p>Lojë: Lojra ndijore.</p> <p>Edukatorja ju mbyll sytë fëmijëve me një shall dhe fëmijët përmes prekjes duhet të dallojnë objektet/shokët.</p>	<p>Mjete didaktike: çarçaf, karton, kuti, kukulla të ndryshme etj.</p> <p>Manuali plotësues</p>
E Martë	<p>Një shfaqje me animator.</p> 	<p>Bisedë: Edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rreth animatorëve. Si ata veshin kostume të ndryshme dhe organizojnë lojra me fëmijët.</p> <p>Edukatorja pyet: Nëse kanë qënë në një ditëlindje apo festë me animator? Cili personazh ju pëlqen më shumë?</p> <p>Punë dore: Krijimi i maskës së një kafshe. (Edukatorja së bashku me fëmijët ndërtojnë maskat e kafshëve dhe të personazheve të përrallës që do të luajnë).</p>	<p>Mjete didaktike: kartona me ngjyra, lapsa me ngjyra, letra me ngjyra.</p> <p>Manuali plotësues.</p>

		<p>Ndarja e roleve të fëmijëve: Përgatitja për shfaqjen “Tre Derrkucët”ose “Kësulkuqja”. Ndarja e roleve të fëmijëve. Përsëritje e përrallës me rolet e ndara.</p> <p>Loja: Domino, Labirinth “Të gjejmë rrugën për në çerdhe”.</p>	
E Mërkurë	<p>Përgatitja për pjesën teatrale.</p> 	<p>Bisedë: Edukatorja i rikujton fëmijëve përrallën “Tre Derrkucët”ose “Kësulkuqja” dhe organizon provat me fëmijët.</p> <p>Ngjyrosje/vizatim: Vizatim i lirë.</p> <p>Loja e lirë: me kukulla, me kuba, lego, etj.</p>	<p>Mjete didaktike: karton, pjata plastike, ngjyra, letra, gërshërë etj</p> <p>Manuali plotësues</p>
E Enjte	<p>Përgatitja për pjesën teatrale.</p>	<p>Aktiviteti: Edukatorja i rikujton fëmijëve përrallën “Tre Derrkucët”ose “Kësulkuqja” dhe organizon prova me fëmijët sipas roleve të ndara më parë.</p> <p>Aktiviteti: Ndërtimi i skenës ku do zhvillohet shfaqja.</p> <p>Këngë lëvizore : “Plaku Donald ka një fermë”.</p>	<p>Manuali plotësues.</p>
E Premte	<p>Realizimi i një shfaqjeje teatrale në çerdhe.</p> 	<p>Aktiviteti: Vënia në skenë e përrallës “Tre Derrkucët” ose “Kësulkuqja”.</p> <p>Lojë e lirë: me lodra/kukulla, me kuba, me lego, etj.</p>	<p>Aparat fotografik, muzikë</p>